	Komiteti Nacional CIGRE Kosovë PUNIM	Nr.
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 1 / 2</i>

Emri dhe Mbiemri i autorit 1*
Emri i Kompanisë/Institucionit
E-mail adresa e autorit 1

Emri dhe Mbiemri i autorit 2
Emri i Kompanisë/Institucionit
E-mail adresa e autorit 2

Emri dhe Mbiemri i autorit 3
Emri i Kompanisë/Institucionit
E-mail adresa e autorit 3

Emri dhe Mbiemri i autorit 4
Emri i Kompanisë/Institucionit
E-mail adresa e autorit 3

UDHËZIME PËR PËRGATITJEN E PUNIMIT PËR KONFERENCË (size: 12)

PËRMBLEDHJA (size: 11)

Qëllimi i këtij udhëzimi është që të gjithë autorët e punimeve të shkruajnë punimin e tyre të standardizuar dhe në mënyrë të unifikuar, me të gjithë titujt e nevojshëm, duke përfshi: përmbledhjen, fjalët kyçe, hyrjen e punimit, elaborimin dhe shtjellimin e temës së punimit, paraqitjen e figurave, tabelave me rezultate, pastaj përfundimin, literaturën e përdorur si dhe detaje të tjera relevante.

Për të gjitha punimet e Konferencës, përmbajtja e punimit nuk duhet të tejkalojë 15 rreshta apo 300 fjalë. Vëmendje duhet t'i kushtohet formulimit të titullit të punimit dhe përmbledhjes së punimit, pasi që lexuesit nga ato do të formojnë përshtypjen e tyre të parë për punimin.

Të gjitha punimet duhet të jenë të unifikuara, prandaj vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet, madhësisë së faqes, distancës midis titullit dhe nëntitullit, gjerësisë dhe lartësisë së tekstit në faqe, dhe detajeve të tjera teknike. **Përdorni këtë Udhëzues si bazë për punimin tuaj.**

Fjalët kyçe: fjala kyçe1; fjala kyçe2; fjala kyçe3; . . . fjala kyçe10.

INSTRUCTIONS TO THE AUTHORS

SUMMARY


The purpose of this instruction is to have the authors write their papers in a standardized and unified manner with all necessary titles, including summary, keywords, introduction of the paper, elaboration of the topic of the paper, presentation of figures, tables with results, then conclusions, references and other relevant details.

For all the Conference papers, the content of the paper should not exceed 15 lines (rows) or 300 words. Attention should be paid to the formulation of the paper title and to the paper summary since readers will get their first impression on the paper from these two items.

All papers should be unified, so special attention should be paid to the size of the page, the distance between the title and sub-title, the width and height of the text on the page, and other technical details. **Use these instructions as a basis for your paper.**

Keywords: keyword1; keyword2; keyword3; . . . keyword10.

*E-mail adresa e autorit 1

	Komiteti Nacional CIGRE Kosovë PUNIM	Nr.
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 2 / 2</i>

1. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME (style: Heading 1, size: 11)

1.1 Natyra e punës (style: Heading 2, size: 11)

Teksti i punimit duhet të përgatitet në formatin Microsoft Word (*.docx)

Përmbajtja e punimit për Konferencën e KN CIGRE KO duhet të jetë material i pa publikuar brenda dhe jashtë vendit në konferenca të ndryshme shkencore ose profesionale, dhe pa reklama. Në këtë drejtim, nuk lejohet të përmenden emrat e prodhuesve brenda në tekst, në tabela apo në figura. Emrat e kompanive, institucioneve ose universiteteve mund të gjenden/vendosen vetëm në krye të faqes së parë (faqja e parë) të punimit, nën emrin e autorit.

KN CIGRE KO do të kujdeset që të formatizon versionin përfundimtar të punimit. Sidoqoftë, autorëve do t'u kërkohet të ndjekin këto Udhëzime dhe të përdorin kriteret e përcaktuara. Recensentët përmes Sekretarit dhe Këshillit Organizativ do t'iu kërkojnë autorëve që të ri formatojnë dhe ta ridërgojnë punimin nëse përmbajtja e punimit nuk përputhet në mënyrë të konsiderueshme me këtë model, p.sh. figurat ose vizatimet me cilësi të dobët në mënyrën që nuk mund të riprodhohen qartë gjatë procesit të shtypjes/printimit, etj.

1.2 Gjuha e Punimit

Punimet mund të shkruhen në gjuhën shqipe ose në gjuhën angleze.

1.3 Gjatësia e Punimit

Gjatësia e punimit rekomandohet që të jetë deri në 8 faqe, derisa gjatësia maksimale e punimit duke përfshi titullin dhe përmbajtjen e punimit në të dy gjuhët nuk duhet të jetë më i madh sesa 10 faqe.

KN CIGRE KO ka të drejtën që të rikthej punimin dhe t'u kërkojë autorëve që të reduktojnë numrin e faqeve të punimit nëse tejkalohet në mënyrë të konsiderueshme numri i rekomanduar i faqeve.

1.3.1 Formati i Punimit (style: Heading 3, size 11)


Formati i punimit duhet të jetë me dimensione 21.0cm x 29.7cm (A4).

Kërkohet që punimi të jetë i rregulluar dhe i standardizuar. Madhësia e shkronjave të tekstit të punimit kërkohet që të jetë 11, përveç nëse kërkohet ndryshe.

Teksti i punimit duhet të shkruhet me font të tipi "Times New Roman". Për shkronjat greke duhet të përdoret tipi i fontit "Symbol".

2. PËRGATITJA TEKNIKE E PUNIMIT

2.1 Struktura e Punimit

	Komiteti Nacional CIGRE Kosovë PUNIM	Nr.
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 3 / 2</i>

Struktura e Punimit duhet të përfshijë: emrin dhe mbiemrin e secilit autorë, titullin e kompanisë ose institucionit ku ata janë punonjës, si dhe e-mail adresat e tyre. Titulli i punimit, përmbledhja (deri në 15 rreshta), fjalët kyçe të shkruara fillimisht në gjuhën shqipe pastaj edhe në gjuhën angleze; pasuar nga hyrja e punimit, teksti i punimit, përfundimi, si dhe lista e literaturës të shfrytëzuar.

2.2 Vendosja e Tekstit

Teksti duhet të vendoset vetëm në një rresht në të njëjtën anë të fletës dhe në tërë gjerësinë e faqes. Distanca e tekstit nga skaji majtas dhe skaji djathtas, si dhe skajit të poshtëm të faqes duhet të jetë 2,5cm.

Për vendosjen e tekstit duhet të përdoret lloji i shkronjave të formatit Times New Roman (Normal) me madhësi 11. Nuk lejohet të përdoren madhësi më të vogla ose më të mëdha të shkronjave. Për të përgatitur punimet në mënyrë efektive, autorët e punimeve për Konferencën e KN CIGRE KO janë të detyruar t'i përpunojnë punimet e tyre në PC (duke përfshi figurat dhe tabelat) dhe t'i dorëzojnë ato nëpërmjet platformës elektronike për bashkëngjitjen e punimeve në faqen e internetit www.cigre-ks.com.

Faqja e parë me titull të punimit dhe faqet e tjera të punimit duhet të përgatiten në atë mënyrë që madhësia e tekstit, distancat dhe vendosja e tekstit në faqe duhet të përputhen plotësisht me kërkesat e paraqitura sipas këtij Udhëzimi.

2.3 Faqja e parë (Titulli i Punimit)

Emri i autorit, kompania apo institucioni, e-mail adresa, titulli i punimit, fjalët kyçe, titujt, nëntitujt dhe teksti i punimit duhet të shkruhen në atë mënyrë dhe formë që të jetë në përputhje me këto "Udhëzime".

Vetëm adresa e autorit kryesor – autorit kontaktues (e shënuar me një “y” menjëherë pas emrit të tij) duhet të shkruhet në fund të faqes së parë.

Në rastin kur ka disa autorë nga e njëjta kompani apo institucion, atëherë emrat/mbiemrat dhe e-mail adresat e këtyre autorëve të shkruhen njëra poshtë tjetrës, në mënyrë që krejt në fund, në rreshtin e ardhshëm të shkruhet emri i kompanisë apo institucionit.


Në rastin kur ka autorë nga kompani apo institucione të ndryshme, atëherë emri i kompanisë ose institucionit duhet të shkruhet nën emrin e autorit derisa e-mail adresa nën emrin e kompanisë ose institucionit. Ngjashëm veprohet edhe me emrin e autorit të ardhshëm, emrin e kompanisë ose institucionit, e-mail adresën, etj.

Mes emrave të autorëve dhe titullit të punimit duhet të lini 3 rreshta të lira (me madhësi 11 secili). Kur janë më shumë se një autor, atëherë emrat e autorëve duhet të shkruhen në dy kolona në pjesën e sipërme në fillim të punimit.

Titulli i punimit duhet të jetë në fontin Times New Roman (bold), me shkronja të mëdha, derisa madhësia e shkronjave të titullit duhet të jetë 12.

2.4 Përmbledhja (Abstrakti)

Midis titullit të punimit dhe Përmbledhjes së punimit (abstraktit) duhet të lihen 2 rreshta të zbrazët, secili me madhësi 11.

	Komiteti Nacional CIGRE Kosovë PUNIM	Nr.
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 4 / 2</i>

Rreshti i parë i përmbledhjes së punimit dhe paragrafët tjerë të rinj duhet të fillojnë të shkruhen të tërhequr për 1,25cm nga ana e majtë e faqes (përmes tastierit Tab). Rreshtat e tjerë brenda paragrafëve duhet të shkruhen pa e tërhequr tekstin.

Përmbledhja e punimit(Abstakti) duhet të përgatitet njëkohësisht në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, në mënyrë që të dyja bashkë të dorëzohen si një dokument i përbashkët, derisa vetëm njëra prej tyre do të përfshihet brenda punimit. Të dyja përmbledhjet(abstraktet) në të dy gjuhët do të publikohen në një dokument të përbashkët së bashku me të gjitha Përmbledhjet e Punimeve tjera të Konferencës.

2.5 Fjalët kyçe

Fjalët kyçe duhet të shkruhen menjëherë pas përmbledhjes(abstraktit).

Midis tekstit të përmbledhjes së punimit dhe fjalëve kyçe duhet të lihet vetëm 1 rresht i zbrazët(me madhësi 11). Titulli i fjalëve kyçe duhet të shkruhet me shkronja të mëdha, bold, me madhësi 11.

Autorët e punimit kanë liri të plotë në zgjedhjen dhe numrin e fjalëve kyçe, sipas udhëzimeve të mëposhtme:

- fjalët kyçe gjithmonë duhet të shkruhen në njëjës,
- numri i rekomanduar i fjalëve kyçe është prej 3 deri në 10 fjalë kyçe ose grup i fjalëve;
- çdo fjalë kyçe duhet të përputhet me një term të saktë.
- disa fjalë komplekse ose grupe fjalësh që përcaktojnë një term të vetëm mund të jenë fjalë kyçe. Nga ana tjetër, fjalët më komplekse që përfaqësojnë dy terma të pavarur të bashkuar duhet të shfaqen si dy fjalë kyçe të pavarura;
- fjalët kyçe përdoren për qëllime të dokumentacionit.

2.6 Hapësirat në tekst dhe distancat në mes rreshtave

Mes titullit të kapitullit dhe nëntitullit ose tekstit vijues duhet të lihet 1 rresht i lirë.

Mes rreshtit të fundit të një kapitulli dhe titullit të kapitullit të dytë të lihen 2 rreshta të lirë.

Mes rreshtit të fundit të një nëntitulli dhe nëntitull të ri (kategoria 1.1) të lihet 1 rresht i lirë.

Mes rreshtit të fundit të një nëntitulli dhe nëntitujve (kategoria 1.1.1) të lihet 1 rresht i lirë.

Asnjëherë mos përdorni rreshta bosh brenda në tekstin e një titulli apo nëntitulli.

2.7 Titujt dhe nëntitujt

Titujt e kapitujve duhet të shkruhen me shkronja të mëdha, ndërsa nëntitujt duhet të shkruhen me shkronja të vogla, madhësia e shkrimit 11, e theksuar me bold.

Numrat e kapitujve duhet të shkruhen në margjinën e majtë të faqes, ndërsa emërtimet e titujve dhe nëntitujve duhet të jenë të tërhequr për 1.25 cm nga margjina (përmes tastierit Tab).

Secilin paragraf të ri duhet me e tërheq për 1.25 cm nga margjina e majtë e faqes.

Titujt e kapitujve dhe nëntitujt duhet të radhiten sipas klasifikimit të decimaleve, si për shembull:

1. TITULLI I KAPITULLIT

1.1. Nëntitulli (kategoria 1.1)

1.1.1. Nëntitulli (kategoria 1.1.1)

2.8 Formulatat

Të gjitha formulatat duhet të shkruhen përmes Microsoft Word Equation duke i vendosur në mes të rreshtit. Shkronjat në formula janë të madhësisë së shkronjave të mëdha, përjashtim bëjnë indeksat dhe fuqitë, madhësia e të cilave është përcaktuar me Microsoft Word Equation në varësi të madhësisë së shkronjave bazë. Në skajin e djathtë të formulës, në të njëjtën rresht, duhet të shkruhet në kllapa numri rendor i formulës, p.sh. (1).

$$\Delta P_{Cun} = 3 \cdot I_n^2 \cdot R \quad (1)$$

ku:

I_n – është rryma nominale

R – është rezistenca

Çdo herë në tekst është e nevojshme të shpjegohen madhësitë e dhëna në formulë.

2.9 Figurat dhe Tabelat

Figurat dhe tabelat duhet të vendosen së bashku me përshkrimin e tyre tekstual. Figurat mund të përgatiten nga disa programe grafike (Corel, Visio, AutoCAD, etj), të shkarkuara nga programe të tjera (p.sh. diagramet e Excel) ose të skanuara por me rezolucion minimal 300 dpi.

Figurat, fotografitë dhe diagramet duhet të referohen me numra arabë nga 1, 2, 3, ... e tutje, ndërsa Tabelat duhet të referohen me numra romakë nga I, II, III, ... e tutje. Numrat rendor dhe emrat e figurave duhet të shkruhen nën figura, si p.sh. "Figura 1. Bllok skema e sistemit".





Figura 1. Bllok skema e sistemit

Me figura duhet të nënkuptohen vizatimet, fotografitë, diagramet dhe të tjera. Figurat nuk duhet të vendosen ndaras në korniza shtesë. Kapitulli ose nëntitulli nuk mund të fillojë me vetëm një skemë, fotografi, vizatim apo një tabelë.

Numrat rendor dhe emrat e tabelave duhet të shkruhen mbi tabelë, p.sh "Tabela I. Rezultatet statistikore të matjeve".

Tabela I. Rezultatet statistikore të matjeve

#	Kolona 1	Kolona 2	Kolona 3
1	125,56	295,78	987,32
2	256,78	568,45	125,56

	Komiteti Nacional CIGRE Kosovë PUNIM	Nr.
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 6 / 2</i>

Emrat e figurave dhe tabelave duhet të jenë në qendër të rreshtit, nën figura apo mbi tabela
Nëpër diagrame duhet të shmanget ngjyra e verdhë.

Figurat duhet të jenë me cilësi të lartë, të mprehta dhe me kontrast të mjaftueshëm.

2.10 Lista e literaturës së përdorur

Literatura e shfrytëzuar duhet të paraqitet në fund të fjalisë, figurës apo tabelës në kllapa katrore, p.sh.: [1] ose numërimi [1], [2] ose [1] - [3], që do të thotë, një fjali, figurë apo tabelë e shfrytëzuar duhet të përfundojë duke iu referuar literaturës së shfrytëzuar p.sh. [2].

Kërkohej që literatura të radhitet sipas rendit në të cilin citohet në tekstin e punimit.

Në rastin kur për qëllime të punimit përdoret dokumentacioni i brendshëm i kompanisë ose ndonjë dokument tjetër i pa publikuar, atëherë nuk duhet të vendoset emri i ndonjë autori si referencë.

Një shembull se si duhet të listohen burimet e punimit, i cili është publikuar në ndonjë revistë apo konferencë, është dhënë në vijim:

[1] Autori 1, Autori 2. "Titulli i punimit", *Emri i revistës ose konferencës*. Numri i revistës, ose data e mbajtjes së konferencës.

Një shembull se si duhet të listohen librat, ose publikime të ngjashme, është dhënë në vijim:

[2] Autori 1, Autori 2. *Titulli i librit*. Vendi i botimit: Botuesi, viti i botimit

3 REKOMANDIME TË NDRYSHME

Punimet e pranuar do të konsiderohen si versioni përfundimtar. Nuk është e mundur që autorët të bëjnë ndonjë ndryshim ose shtim, ose një version të ri të punës, pasi të jetë pranuar punimi.

Është e domosdoshme të dorëzohet versioni elektronik i punimit, si versioni origjinali i punimit dhe një formular i plotësuar për drejtat e autorit.


Gjatë konferencës, Autori i punimit do ta prezantojë punën e tij të përbashkët (me autorët e tjerë), duke përdorur një PC përmes projektorit dhe softuerit MS PowerPoint. Autori duhet t'ia dorëzojë prezantimin Organizatorit/Sekretariatit jo më vonë se një ditë para prezantimit.

Autorët e punimit duhet t'i shmangin ekzekutimet matematikore. Nëse ato janë të nevojshme, atëherë pjesa e tyre duhet të bashkëngjitet si shtojcë në fund të punimit.

4 E DREJTA E AUTORIT

Me qëllim të mbrojtjes së interesave të KN CIGRE KO dhe autorit, secili punim do t'i nënshtrohet të drejtës së autorit në përputhje me Dispozitat e të Drejtave të Autorit të KN CIGRE KO.

Autorët duhet të nënshkruajnë një deklaratë përmes formularit të veçantë për të drejtën e autorit para publikimit të punimit të tyre. Kjo formë është pjesë përbërëse e udhëzimit dhe duhet të nënshkruhet nga autori kryesor/kontaktues dhe si dokument i skanuar të dorëzohet/bashkëngjitet njëkohësisht me punimin nëpërmjet platformës për bashkëngjitjen e punimit.

	Komiteti Nacional CIGRE Kosovë PUNIM	Nr.
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 7 / 2</i>

5 BOTIMI I PUNIMEVE DHE PARAQITJA NË WEB FAQE

USB disku i Konferencës do të përmbajnë të gjitha punimet dhe përmbledhjet. Po ashtu, në një fletushkë të posaçme do të botohen të gjitha Përmbledhjet e punimeve të konferencës, dhe atë në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze.

Prezantimet e punimeve në PDF format dhe/ose në MS PowerPoint do të postohen në faqen e internetit të KN CIGRE KO (www.cigre-ks.com) menjëherë pas përfundimit të Konferencës.

6 E RËNDËSISHME PËR AUTORËT

Autorët duhet të respektojnë rreptësishtë afatin zyrtar të dorëzimit të punimit, pas së cilit prezantimi nuk do të pranohet.

Paraqitja e punimeve nga ana e autorit kontaktues bëhet përmes platformës elektronike për bashkëngjitje të punimeve përmes faqes së internetit www.cigre-ks.com. Lidhur me këtë aplikim, autori kontaktues merr një informatë kthyesë automatike.

Më pas, punimi në MS Word i dorëzohet recensuesit, i cili pasi ta bën recensimin e punimit ia kthen Sekretarit me komente eventuale. Pastaj, Sekretari ia dërgon autorit kontaktues komentet eventuale dhe sugjerimet e recensuesit, ku punimi pastaj mund të ketë nevojë për përpunim nga ana e autorit.

Pas përpunimit të punimit nga ana e autorit, autori përsëri e bashkëngjit punimin si versionin përfundimtar përmes platformës elektronike për bashkëngjitje të punimeve, dhe ky punim pastaj në bazë të vlerësimit të recensuesit mund të konsiderohet si versioni përfundimtar i punimit.

7 PËRFUNDIMI

Çdo punim i përgatitur për Konferencë në pjesën e fundit duhet të përmbajë përfundimin(konkluzionet) lidhur me çështjen dhe temën që e ka trajtuar autori brenda punimit.

Të gjitha punimet duhet të përgatiten sipas këtij Udhëzuesi. Nëse nuk janë, atëherë punimet do t'iu ri-kthehen autorëve për t'i përgatitur ato përsëri.

8 LITERATURA

- [1] Mbiemri 1, Mbiemri 2, "*Titulli i librit*", Publikimi, Shtëpia botuese, muaji dhe viti.
- [2] Mbiemri 1, Mbiemri 2, "*Titulli i punimit*", Konferenca, Përmbledhja e punimeve, vendi, shteti, muaji dhe viti, numri i faqes ose referatit.